

Memorandum Mirëkuptimi midis Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare dhe Dhomës Amerikane të Tregëtisë në Shqipëri.

Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare (këtu e tutje referuar si "DHBD"), një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Bizneseve në Shqipëri, me nr. regjistrimi L92315452O përfaqësuar nga Z. Ardian Lekaj, në cilësinë e tij si Kryetar i DHBD,

dhe

Dhoma Amerikane e Tregëtisë në Shqipëri (në tekstin e mëtejme referuar si "AmCham"), një organizatë jo-fitimprurëse, e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Bizneseve në Shqipëri, me nr. regjistrimi K11506006O, përfaqësuar nga Z. Enio Jaco, në cilësinë e tij si Kryetar i Bordit të Drejtorëve dhe President i AmCham,

Duke njohur misionin e AmCham për të përmirësuar, mes të tjerash, klimën e biznesit në Shqipëri, për të rritur numrin dhe sasinë e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, veçanërisht të atyre investimeve me origjinë nga Shtetet e Bashkuara, për të avancuar interesat dhe shqetësimet e bizneseve amerikane në Shqipëri , dhe për të promovuar rritjen ekonomike dhe sistemin e ndërmarrjeve të lira në Shqipëri;

Duke njohur edhe rëndësinë që DHBD i kushton marrëdhënies midis diasporës shqiptare dhe promovimit dhe rritjes së sistemit të ndërmarrjeve të lira në Shqipëri dhe tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri;

Duke njohur natyrën strategjike të partneritetit midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara, veçanërisht në reformën në drejtësi dhe në të gjitha fushat ekonomike dhe tregtare;

Duke marrë parasysh që DHBD dhe AmCham potencialisht mund të përfitojnë nga një bashkëpunim i shtuar ndërmjet tyre;

KANE ARRITUR mirëkuptimin si më poshtë vijon:

I. QËLLIMI

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është të vendosë parimet dhe bazën për një bashkëpunim të shtuar midis DHBD dhe AmCham me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit shqiptar dhe rritjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri.

Duhet të kuptohet se DHBD dhe AmCham janë, dhe do të mbeten, njësi të pavarura dhe asnjëri nuk do të veprojë si agjent për tjetrin. Asnjëra nga organizatat nuk do të veprojë si përfaqësuese për tjetrën, dhe as njëra nga organizatat nuk do të ketë autoritetin për të lidhur tjetrën me ndonjë kontratë ose marrëveshje, dhe as për të drejtuar aktivitetet e tjetrës. Çdo njësi ekonomike në çdo kohë vepron në emër të dhe përfaqëson interesat e anëtarësisë së saj përkatëse.

II. FUSHËVEPRIMI

DHBD dhe AmCham do të punojnë vullnetarisht së bashku për të nxitur rritjen e biznesit, për të përmirësuar klimën e biznesit brenda dhe midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara si dhe të shërbejnë si një burim informacioni për të nxitur një rritje të tillë.

Fushëveprimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi përfshin bashkëpunimin në fushat e mëposhtme:

A) Koordinimi i politikave, avokimi dhe aktivitetet e promovimit të biznesit, veçanërisht në temat e tregtisë dhe investimeve midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara.

B) Shkëmbimi i informacionit në lidhje me mundësitë për të mbështetur investitorët e mundshëm të diasporës në Shqipëri, me qëllim të aktualizimit të investimeve të tilla dhe ofrimin e mbështetjes së AmCham për investitorë të tillë përmes anëtarësimin në AmCham.

C) Bashkëpunimi midis stafit të DHBD dhe AmCham në lidhje me çdo aktivitet të përbashkët promovues të rënë dakord.

D) Krijimi dhe mirëmbajtja e një baze të dhënave që mbledh informacione në lidhje me investimet e mundshme në Shqipëri që vijnë nga diaspora shqiptare në Shtetet e Bashkuara.

E) Bashkëpunimi synon të mbështesë përpjekjet e AmCham për të ndihmuar anëtarët e saj me nevoja të ndryshme nga institucionet qeveritare dhe / ose autoritetet dhe palët e treta.

Bashkëpunimi dhe aktivitetet në fushat e sipërpërmendura do të përqipen të promovojnë tregtinë dhe investimet si dhe të krijojnë një mjedis më të mirë biznesi në Shqipëri.

III. BURIMET FINANCIARE

Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk përfshin transferimin e burimeve financiare midis nënshkruesve, secili prej të cilëve do të mbajë shpenzimet e nevojshme në lidhje me veprimtarinë e tyre përkatëse.

DHBD dhe AmCham po hyjnë vullnetarisht në këtë Memorandum Mirëkuptimi si të barabartë. Asnjëra nuk po punëson apo mban tjetrën. Asnjë nuk do të përfaqësojë dhe as nuk do të shërbejë si agjent i tjetrit dhe asnjëri nuk do të kompensojë tjetrin për çdo veprimtari të ndërmarrë në përmbushjen e qëllimeve të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

IV. MODIFIKIMET

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të modifikohet në çdo kohë me marrëveshje midis DHBD dhe AmCham. Të gjitha modifikimet e tilla duhet të bëhen me shkrim dhe të nënshkruhen nga individë të përshtatshëm nga të dyja organizatat.

V. HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të mbetet në fuqi deri në shkëputjen e tij nga secila prej palëve.

VI. NOTICE

Ky Memorandum Mirëkuptimit mund të shkëputet në çdo kohë nga secili nënshkrues përmes njoftimit me shkrim.

VII. PËRDORIMI I EMRIT DHE MARKËS TREGTARE

Emri dhe marka tregtare e nënshkruesve mund të përdoren reciprokisht nga nënshkruesit, ekskluzivisht në ndjekjen e objektivit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, për aq kohë sa pronari i palës së markës tregtare e autorizon paraprakisht dhe shprehimisht me shkrim, në të kundërt, pala shkelëse do të mbahet përgjegjëse për humbjet dhe dëmet që vijnë nga përdorimi i paautorizuar.

Nënshkruesit nënshkruan këtë Memorandum Mirëkuptimi në dy (2) kopje origjinale, përpara një Noteri të autorizuar rregullisht ose ekuivalentit të tij sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Tiranë, Shtator, 2020.

Enio Jaco, President
Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri

Ardian Lekaj, Kryetar
Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare